



Datë: 03.12.2025
Numër Protokolli: 7709/2025

A.nr.1911/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, dhe Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1911/2025, të datës 17.11.2025, të parashtruar nga ankuesi E.R, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*pezullim i marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedura administrative e iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1911/2025, të datës 17.11.2025, të parashtruar nga ankuesi E.R.

A r s y e t i m

Ankuesi, E.R (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 16.11.2025, përmes emailit ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 17.11.2025 nën shenjen A.nr.1911/2025, kundër Vendimit Nr. i Ref:183/2025, të datës 11.11.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për shkak të shkeljes së nenit 70, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe paragrafin 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, mos marrjes parasysh të gjendjes faktike dhe shtrembërimit të qëllimit të kërkesës për pezullim vullnetar të marrëdhënies së punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.11.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 25.11.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë më sqarimin së me kërkesë vullnetare të ankuesit të datës 17.11.2025, për dorëheqja nga shërbimi diplomatik, Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së më Vendimin ref.1445/2025 të datës 19.11.2025, ka bërë përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të provave të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankuesit, **sepse:**

Vlerësimi i gjendjes së çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr. 847/2024, të datës 01.08.2024, ka ushtruar pozitën Zyrtar i Misionit Diplomatik në Departamentin për NATO dhe Politika të Sigurisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- Më datë 16.06.2025, ankuesi ka parashtruar kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm i MPJD, për pezullimin vullnetar të marrëdhënies së punës, për periudhën një (1) vjeçare, për shkak të kujdesit ndaj prindit të sëmurë.
- Më kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm, Zyra Ligjore e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 21.07.2025, ka dhënë opinionin ligjor lidhur me kërkesën e ankuesit, duke sqaruar se: në rastin e ankuesit ekziston Vendimi Nr. Ref.71/2025 i datës 13.03.2025 i Ministres së MPJD-së për emërimin në mision diplomatik në Republikën e Italisë, dhe se në këtë situatë deri sa është në fuqi një vendim i vlefshëm për caktimin në mision jashtë vendit është e palejueshme juridike që të ketë një vendimmarje tjetër që cenon në esencë vendimin dhe vullnetin e shprehur të titullarit të institucionit, e për rrjedhojë është rekomanduar mos aprovimi i kërkesës për pezullim vullnetar të marrëdhënies së punës.
- Pas opinionit të Zyrës Ligjore, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 21.07.2025 ka njoftuar ankuesin se pas rekomandimit të dhënë nga Zyra Ligjore, kërkesa nuk aprovohet.
- Ankuesi kundër përgjigjes së Sekretarit të Përgjithshëm të datës 21.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshill, ndërsa, ky i fundmit përmes Vendimit A.nr. 1604/2025, të datës 25.10.2025, ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të shqyrtoj kërkesën e datës 16.06.2025,. të ankuesit dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat materiale.
- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në zbatim të vendimit të Këshillit A.nr.1604/2025, më datë 11.11.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. i Ref:183/2025, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit për pezullim vullnetar nga marrëdhënia e punës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me Nr. i Ref:183/2025, të datës 11.11.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke pretenduar se akti i kontestuar është në nxjerrë në kundërshtim me nenin 70, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe në këtë vendim janë përdorur apo cekur masa disiplinore vërejtje me shkrim apo kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore të cilat nuk kanë qenë objekt i kërkesës. Kërkon të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar me ankesë dhe të obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të bëjë zbatimin e vendimit të KPMSHCK-së.

Andaj, marrë parasysh faktin se objekti i kontestit është kundërshtimi i ligjshmërisë së Vendimit me Nr. i Ref:183/2025, të datës 11.11.2025, lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për pezullim vullnetar të marrëdhënies së punës, e duke qenë se ankuesi është liruar nga shërbimit civil pas kërkesës për dorëheqje, më efekt nga data 01.12.2025, atëherë, mbi këto rrethana juridike, objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ sipas ankesës së ankuesit të datës 17.11.2025, është bërë i pamundur, sepse, Këshilli nuk mund të vendos për ligjshmërinë e aktit më të cilin është refuzuar kërkesa për pezullimin e marrëdhënies së punës e përfunduar më vet vullnetin e ankuesit, kështu që, në kuptim të

dispozitive të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”, Kolegji vendosi në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1911/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit E.R;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;